



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Nr. 508/2 Prot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. 1840 Prot

MARRËVESHJE BASHKEPUNIMI

NISUR NGA:

Shqetësimi i opinionit publik shqiptar për nivelin e lartë të korrupsionit në administratën publike në Shqipëri, si dhe Prioritetet e institucioneve shqiptare dhe kërkesat e vazhdueshme të organizmave të ndryshme ndërkombëtare për forcimin e luftës kundër fenomenit të korrupsionit në administratën publike në Shqipëri

ME SYNIM:

Rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm për forcimin e luftës kundër korrupsionit nga punonjësit e administratës publike.

DUKE RIAFIRMUAR

Vendosmërinë për respektimin rigoroz të Kushtetutës, Kodit të Procedurave Administrative dhe Kodit Penal, Kodin e Procedurës Penale, dhe ligje të tjera që parashikojnë vepra penale, gjatë proceseve respektive të punës së të dy institucioneve.

NË MBËSHTETJE TË:

Ligjit nr.8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" i ndryshuar, neni 12 germa (g) e cila përcakton për "materialet të cilat i dërgohen Prokurorisë për ndjekje penale" si dhe,

Ligjit nr.8737, datë 12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar,

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), i cili është autoritet kompetent për qëllimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit, përfaqësuar nga **Kryetari z. Bujar Leskaj**, që këtu e më poshtë do t'i referohemi si palë,

dhe

Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, i cili është autoritet kompetent për qëllimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit, përfaqësuar nga **Prokurori i Përgjithshëm znj. Ina Rama**, që këtu e më poshtë do t'i referohemi si palë,

Bien dakort mbi Marrëveshjen e Bashkëpunimit si më poshtë:

NENI 1 OBJEKTIVI

- 1.1** Realizimi i bashkëpunimit të ndërsjelltë ndërmjet palëve, për shkëmbimin e informacioneve midis dy institucioneve me qëllim evidentimin e saktë të shkeljeve, që përbëjnë veprë penale në fushën e administrimit të fondeve publike, administrimit të pronës publike dhe privatizimit të saj.
- 1.2** Marrja e masave për plotësimin e rregullt të kallëzimeve penale, kryerjen e hetimeve paraprake, ushtrimin e ndjekjes penale, ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës në afate sa më të shpejta, në zbatim të ligjit penal dhe procedural penal.
- 1.3** Rritja e efikasitetit dhe bashkëpunimit ndërinstytucional në luftën kundër veprave penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit.
- 1.4** Informimi për çështje të tjera me interes të përbashkët të Palëve në këtë Marrëveshje.
- 1.5** Palët do të bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacion për realizimin e detyrave respektive, pa cënuar diskrecionin e njëra tjetrës dhe sekretin hetimor.

NENI 2 KONTRIBUTI I KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT

- 2.1** Në rastet kur KLSH bën kallëzim penal në prokurori, materiali, përveç kërkesave të parashikuara në nenin 281 të Kodit të Procedurës Penale, duhet të shoqërohet edhe me një relacion përmbledhës të faktit të konstatuar dhe elementëve të veprës penale të dyshuar; me proces verbalet dhe aktverifikimet dhe çdo dokument tjetër të mbajtura nga kontrollorët e KLSH në lidhje me faktin e konstatuar dhe të referuar si veprë penale; me observacionet e personave përgjegjës ku paraqiten pretendimet e tyre; çdo dokument tjetër që është i nevojshëm për të vërtetuar konstatimet e KLSH-së në lidhje me kryerjen e veprës penale për të cilën është bërë kallëzimi.
- 2.2** Në çdo rast që KLSH bën kallëzim në prokurorinë kompetente, një kopje e kallëzimit së bashku me relacionin përmbledhës, i dërgohet për dijeni Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

NENI 3

KONTRIBUTI I PROKURORISË

- 3.1** Gjatë fazës së hetimeve paraprake dhe gjykimit të procedimeve penale të regjistruara mbi bazën e kallëzimit penal të bërë nga KLSH, pikat e kontaktit do të realizojnë, sa herë që të jetë e nevojshme, takime ndërmjet kontrollorëve të KLSH që kanë ndjekur rastin dhe prokurorëve që ndjekin procedimin penal, me qëllim sqarimin sa më të plotë të rrethanave dhe fakteve objekt hetimi.
- 3.2** Kur gjatë hetimeve paraprake të procedimeve penale të regjistruara mbi bazën e kallëzimit të KLSH është e nevojshme të kryhen kontrole më të plota ose duhen verifikuar probleme të tjera që kanë dalë nga hetimi i këtyre procedimeve (brenda objektit të punës së KLSH), Kontrolli i Lartë i Shtetit pas kërkesës së prokurorit të çështjes do të kryej verifikimet e duhura dhe njofton Prokurorinë për konkluzionet e arritura.
- 3.3** Në përfundim të hetimit të procedimeve penale të rregjistruara mbi bazën e kallëzimit të bërë nga KLSH, Drejtuesi i Prokurorisë kompetente, informon KLSH për mënyrën e përfundimit të tyre, duke dërguar një kopje të vendimit të pushimit ose të kërkesës për gjykim.

NENI 4

KONTRIBUTE TË PËRBASHKËTA

- 4.1** Palët marrim përsipër që të organizojnë takime të përbashkëta periodike ndërmjet punonjësve të KLSH, prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të specializuar për hetimin e veprave penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit, me qëllim shkëmbimin e opinioneve dhe eksperiencave për kuptimin, interpretimin dhe zbatimin e drejtë të rasteve për të cilat bëhet kallëzimi penal, të cilat janë objekt i punës së dy institucioneve

NENI 5

KOORDINIMI NDËRMJET PALËVE

- 5.1** Palët për zbatimin e kësaj marrëveshje caktojnë nga një person kontakti për secilin institucion.
- 5.2** Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në vazhdimësi, në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni. Objekti i shkëmbimit të informacionit ndërmjet tyre do të jetë sipas nenit 1 të kësaj marrëveshje.
- 5.3** Personat e kontaktit do të informojnë në vazhdimësi drejtuesit e dy institucioneve në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshje.

NENI 6
ADMINISTRIMI I INFORMACIONIT

- 6.1 Informacioni i shkëmbyer mes Palëve administrohet sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare", ligjin nr. 8517, datë 22.7.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".
- 6.2 Gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje asnjë nga institucionet apo pikat e kontaktit nuk do të ushtrojë ndikim për të mos u dërguar një kallëzim penal në prokurori.

NENI 7
DISPOZITAT E FUNDIT

- 7.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar.
- 7.2 Amendamentet mund të bëhen me marrëveshje nga Palët nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim, duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi.
- 7.3 Megjithë sa është parashikuar në pikën 7.1 të këtij neni, kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar paraprakisht me shkrim, palën tjetër.
- 7.4 Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe dy të tjera në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm.

Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi u nënshkrua sot, më datë 28/06 2012.

PËR
KONTROLLIN E LARTË TË SHTETIT



PËR
ZYRËN E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

